



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802034/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandim për garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Qendrën Sociale "Të qëndrojmë së bashku", Tiranë.

BASHKISË TIRANË

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMEVE SOCIALE

ZONJËS ANISA RUSËTI

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT SOCIAL

SHTETËROR

ZONJËS LUNEDA SUFALI

QENDRËS SOCIALE "TË QËNDROJMË SË BASHKU"

ZONJËS MIMOZA AGALLIU

TIRANË

Të nderuar,

Një nga sfidat kryesore të veprimtarisë të institucionit tonë është mbrojtja, promovimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve e, në mënyrë të dedikuar, një nga grupet më të ndjeshme, e përbëjnë padyshim fëmijët me aftësi të kufizuara. Përmirësimi i shërbimeve, që shoqëria jonë ofron për fëmijët dhe adoleshentët, promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në kujdesin

shoqëror dhe shëndetësor, si dhe në të gjitha institucionet rezidenciale apo ditore, ku ata janë, përbëjnë pjesë të punës të përbashkët.

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit¹ ka kryer një inspektim të përgjithshëm në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Tiranë.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t’Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

-së pari, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e institucionit, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin;

-së dyti, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve;

-së treti, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit, ku ofrohen shërbimet për fëmijët.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit ka zhvilluar bisedën përmyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin, në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit.

¹ Inspektimi u krye në datën 16.10.2018, sipas urdhrit nr.327, datë 6.9.2018, të “Avokatit të Popullit “Për inspektimin e institucioneve të përkuqdesit social, rezidencial dhe ditor, që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë”.

Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku” është një institucion publik, në varësi të Bashkisë Tiranë, krijuar me vendimin nr.60, datë 24.12.2012, të Këshillit Bashkiak të Tiranës, dhe urdhrin nr.33192, datë 1.11.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku””.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e kësaj qendra është miratuar me vendimin nr.7432, datë 24.2.2017, të kryetarit të Bashkisë Tiranë².

Profili social i Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”

Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku” Tiranë, është qendër ditore për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, si dhe persona të moshuar (të vetmuar, të braktisur, me probleme sociale).

Këta përfitues marrin shërbim ditor, duke përfshirë vaktin e ushqimit të drekës, terapistë e ndryshme, duke u përmbledhur nën termin e tipologjive të shërbimit ditor. Konkretisht, misioni i kësaj qendre, është ofrimi i shërbimeve mbështetëse multidisiplinare për personat me aftësi të kufizuara, të moshuar të vetmuar, familje në nevojë, gra të dhunuara, etj.

Meqënëse ndodhet në territorin e Njësisë Administrative nr.6, njëkohësisht kjo qendër mbulon nevojat e grupeve sociale të këtij komuniteti, si edhe të Njësisë Administrative nr.7, Vaqarr e Kashar, me qëllim lehtësimin e kushteve dhe situatës social-ekonomike dhe, përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Numri i përfituesve të qendrës

Gjatë realizimit të inspektimit, në qendër ofroheshin shërbime për afërsisht 100 përfitues, 50 ishin fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, 11 nga të cilët ishin të rinj mbi 18 vjeç. Shërbim tjetër, që ofrohet ishte këshillimi dhe referimi për rastet e grave të dhunuara.

Kapaciteti prej 50 të rinjsh dhe fëmijësh konsiderohej optimal për t’iu përgjigjur problematikave të gjithsecilit, por drejtuesit e qendrës kanë kërkuar shtimin e kapaciteteve në burime njerëzore dhe shtesë fondesh për trajtimin e të moshuarve.

Patologjitë e sëmundjeve janë çrregullime të spektrit të autizmit dhe “sindroma down”, prapambetje mendore.

² Miratuar me urdhrin nr.33192, datë 1.11.2016, të kryetarit të bashkisë Tiranë “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku””.

Nga vlerësimi i diagnozave, 20 përfitues kishin probleme të autizmit, ndërsa pjesa tjetër kishin problematika të prapambetjes së lehtë mendore dhe të “*sindromës down*”.

Krijimi i grupit multidisiplinar, me urdhër të drejtuesit të qendrës, ishte për të gjithë vitin dhe, detyrë e tij ishte, jo vetëm vlerësimi psiko-social i përfituesve të rinj, por edhe realizimi i vlerësimit çdo 6 muaj i planit të kujdesit, planit individual i përfituesve me aftësi të kufizuara dhe vlerësimit të tij. Ky proces bazohet në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e qendrës sociale.

Kuota financiare për shpenzimet ditore ushqimore, e përcaktuar për këta fëmijë/përfitues në këtë institucion me frekuentim ditor publik, ishte 1600 lekë, e përcaktuar me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Punonjësit ishin të trajnuar për rreziqet e mundshme nga zjarri dhe mbrojtjen përkatëse. Në korridoret e godinës ishin vendosur rregullisht bombolat e shuarjes së zjarrit, të cilat ishin të kolauduara brenda afateve dhe në funksion të rregullt.

Kutia e ankesave ishte e vendosur në mjediset e godinës, hapej një herë në muaj në praninë e përfaqësuesve të njësisve administrative. Në vijim, është konstatuar, që nuk kanë patur asnjë ankesë nga ana e fëmijëve dhe të rinjve.

Burimet njerëzore

Struktura e qendrës ka gjithsej 25 punonjës me kohë të plotë. Nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara.

Trajnimi i punonjësve ishte kryer para një viti nga ana e Bashkisë së Tiranës, për një periudhë 1 javore. Veç kësaj, trajnime janë kryer edhe me prindërit e fëmijëve ose kujdestarët e tyre, sipas problematikave që janë konstatuar. Mbledhjet me prindërit zhvilloheshin rregullisht.

Organigrama e qendrës përbëhet nga:

-drejtori;

-përgjegjësi i përkujdesit social;

(mjeku neuropsikiatër, psikologu, 2 punonjës socialë, 2 terapistë, fizioterapisti, edukatori dhe operatori social-edukator, si dhe juristi);

-financieri (që ka në varësi ndihmësin e kuzhinës, 2 roje/mirëmbajtës, 2 sanitare dhe shoferin).

Pozicioni i “mjekut” në qendër ishte vakant, pasi është kërkuar zëvendësimi i tij në organigramë, me një psikolog ose logopedist, pasi konsiderohet më i domosdoshëm për shërbimet ndaj përfituesve me aftësi të kufizuara.

Shërbimet e ofruara në këtë qendër zhvillimi janë:

- seanca edukativo-mësimore;
- mbështetje psiko-sociale;
- shërbim i fizioterapisë/okupacionale, terapi individuale, terapi arti;
- këshillimi psikologjik individual dhe në grup;
- shërbime mbështetëse për fëmijët me autizëm;
- takime me prindër, për rritje të kapaciteteve në fushën e aftësisë së kufizuar;
- vizita në familje;
- shërbimi i ushqimit me catering;
- veprimtari sociale e argëtuese për përfituesit e qendrës;
- shërbimi i transportit për këta përfitues.

Nisur nga profili i një qendre sociale e ditore, frekuentimi dhe shërbimet që ofrohen kanë kohëzgjatje nga ora 8.00-16.00. Transporti i fëmijëve dhe të rinjve mbulohet nga buxheti i qendrës, ndaj marrja e tyre nga banesat fillon në orën 7.30 të çdo dite. Përveç shoferit asistohen në transport edhe nga mësuesja ndihmëse.

Edhe pse kjo qendër mbulonte Njësitë Administrative nr.6 dhe 7, si dhe zonën e Vaqarrit dhe të Kasharit në Tiranë, kishte fleksibilitet edhe për të pranuar përfitues nga njësi të tjera administrative të Tiranës, në varësi të problematikave që paraqiteshin. Për këtë arsye kishte frekuentim të fëmijëve edhe nga Peza, Ndroqi, Njësitë Administrative nr.5 dhe nr.10, Tiranë.

Risia e kësaj qendre ishte ofrimi i shërbimeve sociale dhe psikologjike për afro 800 familje në nevojë.

Dosjet e përfituesve të qendrës përmbanin kontratën tip, planin e kujdesit për të miturit dhe, rregullisht plotësoheshin e menaxhoheshin nga punonjësi social dhe psikologu.

Të drejtat e detyrimet e përfituesve nga shërbimet e kësaj qendre ishin të afishuara në mjediset e saj.

Mjediset dhe kushtet e godinës

Sistemi i ngrohjes funksionon me kaldajë (me naftë), e cila siguron ngrohje qendrore për të gjithë qendrën, ndërsa kondicionerët funksionojnë për stinën e verës.

Organizimi i godinës së fëmijëve dhe të rinjve, e cila ishte veçmas asaj të të rriturve, është me 3 dhoma terapie grupi, një kënd argëtimi, një dhomë fizioterapie, mensa, kuzhina, dy dhoma terapie individuale, salla e aktiviteteve si dhe tualetet.

Godina e qendrës ishte një katëshe dhe faktikisht, nuk kishte fëmijë me vështirësi në lëvizje. Nga bashkëpunimi me donatorë është përmirësuar infrastruktura e saj, ndërkohë, që izolimi i tarracës së godinës është kryer nga një grup donatorësh (si EHW e KMY). Aktualisht, qendra ka mungesë të monitorimit me sistem kamerash.

Në mjediset e jashtme të godinës, oborri është i sistemuar mirë me lulishte, mjedis, në të cilin zhvilloheshin aktivitete sociale dhe okupacionale.

Në kuadrin e garantimit, që fëmijët dhe përfituesit me aftësi të kufizuara, të marrin kujdesin e duhur dhe në kohën e duhur, dhe në përmbajtje të këtij inspektimi të realizuar në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Tiranë, ajo që konstatohet, është si vijon:

- mungesë shërbimesh për disa kategori të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që do të thotë nevoja për shtimin e tipologjive të shërbimit, si dhe për shërbimet e reja për personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç e që mund t’i kryejnë vetë nevojat personale;
- nevoja e referimit dhe e bashkëpunimit midis Qendrës të Zhvillimit dhe Mirërritjes me njësitë administrative dhe Komisaritet e Policisë, për rastet e dhunës në familje, sipas përcaktimeve të vendimit nr.578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”³ ;
- nevoja për ndihmë ligjore falas dhe shërbime psikologjike për rastet e veçanta të grave të dhunuara;
- në rastet emergjente, kur fëmijët duhen dërguar në shtëpi, ose duhen kryer verifikime, nuk mbulohen shpenzimet e karburantit të automjetit, ndaj sugjerojmë, që të parashikohet si zë më vete kjo shtesë në buxhet;
- psikologët nuk ishin të regjistruar në Urdhrin e Psikologut, ashtu siç e parashikon ligji nr.40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në RSH” ;

³ Kreu IV “Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve e të strukturave për menaxhimin e rastit”, neni 27 “1.Punonjësit e ofruesit të shërbimeve për fëmijë, publike ose private, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë...”

- rregullorja e kësaj qendre, e ka të parashikuar, që nuk pranon persona që nuk mund t'i kryejnë nevojat personale, por rezultonte, që dy të rinj që merrnin shërbime në qendër kishin nevojë dhe ishin me pampersa;
- plotësimi i stafit të qendrës edhe me logopedist⁴;
- nevoja e vendosjes së sistemit të kamerave në qendër, me qëllim monitorimin e të gjitha veprimeve, që mund të cenojnë sigurinë fizike dhe psikologjike të atyre që janë më të pambrojturit.

Për këtë qëllim, në mbështetje edhe të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, dhe në funksion të garantimit të misionit të kësaj qendre në ndihmë e shërbim edhe të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara,

R E K O M A N D O J M Ë:

- Marrjen e masave, për shtimin e tipologjive të shërbimit, për shërbimet e reja për personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç.
- Marrjen e masave për përmbushjen korrekt të procedurave të referimit, menaxhimit dhe bashkëpunimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr.578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
- Marrjen e masave për regjistrimin e psikologëve të qendrës në Urdhrin të Psikologut, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Marrjen e masave për shtimin logopedistit, si staf i qendrës.
- Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të mbikqyrjes me kamera në qendër.

⁴ Pika 7 e vendimit nr.518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, ka përcaktuar **se qendrat ditore, sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve...**”. Konkretisht, për personat me aftësi të kufizuara, shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe, të kthejnë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA